VENDIM
Nr. 414, datë 15.6.2022

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI NGA MINISTRIA E MBROJTJES TEK BASHKIA LIBRAZHD, TË PRONËS NR. 755, ME EMËRTIM "ISH-GRUP DEPO", ME VENDNDODHJE NË MURRASH, LIBRAZHD, ZONA KADASTRALE 2696, PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR, DHE NË VENDIMIN NR. 1086, DATË 28.10.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË LIBRAZHD, TË QARKUT TË ELBASANIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, e të neneve 3, 5, 7 dhe 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Librazhd, të pronës nr. 755, me emërtim "Ish-grup depo", me vendndodhje në Murrash, Librazhd, zona kadastrale 2696, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ndërtimin e një pike grumbullimi të produkteve bujqësore për fermerët e kësaj zone.
2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, të hiqet prona nr. 755, me emërtim "Ish-grup depo", me vendndodhje në Murrash, Librazhd, zona kadastrale 2696, sipas planrilevimit, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1086, datë 28.10.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Librazhd, të qarkut të Elbasanit", të ndryshuar.
3. Bashkisë Librazhd i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë atë në përdorim të tretëve.
4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Bashkia Librazhd dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE
Prona nr.755 (Pasuria 2355), "Ish Grup Depo" Murrash, Librazhd

PRONAR SHTET MM (Komanda Mbështetëse) DATË13/04/2021 QËLLIMI Transferim nga MM tek Bashkia Librazhd

VENDNDODHJA
Bashkia Librazhd DVASHK/ZVASHK Librazhd Nr.Pasurisë 2355 ZK 2696 Indeksi i Hartës K-34-101-121-B

TE DHËNAT E PASURISË
Lloji i pasurisë Truall Sip e pasurisë 35379 m² Sip e gjurmës së ndërtimit 1523 m² Nr. kateve 1 Nr. pemeve

Nord = 4560911.470
East = 523017.391

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)

Nord = 4560911.470
East = 523457.301



Nord = 4560560.400
East = 523017.391

SH I: 2500

Nord = 4560560.400
East = 523457.301

NR ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT
1 Veri			9	K51726024H
2 Lindje			—	K51726024H
3 Jug			18, 23	K51726024H
4 Perëndim			23	K51726024H

RIPUNOI PËR IGJIU
Specialist Edison MEMELLI
KONFIRMOI PËR IGJIU
DREJTORI Ing. Edmond **MORINA**

REALIZOI PËR ASHK
Specialisti_____
DVASHK_____
Nënshkrimi_____
KONFIRMOI
Përgjegjësi/Drejtori_____
Nënshkrimi/ Vula_____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE T, Z, O
PËRCAKTIMI I KUFIRIT P, HK

SHËNIME TË VEÇANTA:
Ky plan rilevimi u rihartua në zbatim të shkresës së KM nr.1870/1, datë 01.04.2021 dhe bazuar në dokumentacionin hartografik marrë në arkivin e IGJIU dhe dokumentacionit të marrë nga AKSH, Librazhd. Azhornimi në terren i pronës u krye në prani të përfaqsuesit të KM.

PRONARI SHTET, MM (Komanda Mbështetëse)
MIRATOHET
KOMANDANTI I KOMANDES MBESHTETESE
Gjeneral Brigade Ilir **XHEBEXHIA**

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE
Prona nr.755 (Pasuria nr.2354), "Ish Grup Depo" Murrash, Librazhd

PRONAR SHTET MM (Komanda Mbështetëse) DATË13/04/2022 QËLLIMI: Transferim nga MM tek Bashkia Librazhd

VENDNDODHJA
Bashkia Librazhd DVASHK/ZVASHK Librazhd Nr.Pasurisë 2354 ZK 2696 Indeksi i Hartës K-34-101-121-B

TE DHËNAT E PASURISË
Lloji i pasurisë Truall Sip e pasurisë 2220 m² Sip e gjurmës së ndërtimit 145 m² Nr. kateve 1 Nr. pemeve

Nord = 4560911.470
East = 523017.391

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)

Nord = 4560911.470
East = 523457.301



Nord = 4560560.400
East = 523017.391

SH 1: 2500

0 25 50 100 METRA

Nord = 4560560.400
East = 523457.301

NR	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT
1	Veri			33	K51726024H
2	Lindje			23	K51726024H
3	Jug			23	K51726024H
4	Perëndim			—	K51726024H

RIPUNOI PËR IGJIU
Specialist Edison MEMELLI

KONFIRMOI PËR IGJIU
DREJTORIing. Edmond **MORINA**

REALIZOI PËR ASHK
Specialisti_____
DVASHK_____
Nënshkrimi_____
KONFIRMOI
Përgjegjësi/Drejtori_____
Nënshkrimi/ Vula_____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE T, Z, O
PËRCAKTIMI I KUFIRIT P, HK

SHËNIME TË VEÇANTA:
Ky plan rilevimi u rihartua në zbatim të shkresës së KM nr.1870/1, datë 01.04.2021 dhe bazuar në dokumentacionin hartografik marrë në arkivin e IGJIU dhe dokumentacionit të marrë nga AKSH, Librazhd. Azhornimi në terren i pronës u krye në prani të përfaqsuesit të KM.

PRONARI SHTET, MM (Komanda Mbështetëse)

MIRATOHET
KOMANDANTI I KOMANDES MBESHTETESE
Gjeneral Brigade Ilir **XHEBEXHIA**